



Datë: 01.08.2025

Numër Protokolli: 5203/2025

A.nr.913/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar në procedurë sipas ankesës A.nr.913/2025, të datës 20.05.2025, të parashtruar nga ankuesi U.E, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat Xhafer Tahiri, nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.913/2025, e datës 20.05.2025 e parashtruar nga ankuesi U.E, ashtu që aprovohet pretendimi ankimor i ankuesit se akti i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me parimin e informimit lidhur me marrëdhënien e punës si dhe dispozitave të LPPA-së.

II. Anulohet Vendimi Nr.Ref.92/2025 i datës 21.03.2025 i Ministres të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

III. Obligohet Ministria e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të ndërmarrë të gjitha veprimet juridike me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, U.E, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 16.05.2025 përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar ankesë, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar me datë 20.05.2025 dhe është regjistruar me numër protokolli 3275/2025, kundër

Vendimit Nr.Ref.92/2025 të datës 21.03.2025 të Ministrisë së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.05.2025 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesi nga Ministria e Punëve të jashtme dhe Diasporës (tutje: MPJD), ndërsa kjo e fundit më datë 26.05.2025 ka përcjellë përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ndërsa Kolegji i Këshillit me datë 11.07.2025 ka kërkuara sqarime shtesë nga organi i punësimit, përgjigje të cilën Këshilli e ka pranuar me datë 11.07.2025.

Kryetari i Këshillit, me datë 27.06.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjën A.nr.913/2025 të datës 27.05.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën e datës 20.05.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e përfaqësuesit të palës; Vendimit Nr.Ref.92/2025 të datës 21.03.2025 të Ministrisë së MPJD; Dekretin e Presidentit të Kosovës i datës 11.10.2019; Shkresë e datës 27.11.2019; Dekretin e Presidentes së Kosovës të datës 29.12.2021; Vendimin e datës 22.02.2022 të Ministres së MPJD-së; Akt Emërimit e ankuesit të datës 24.11.2022; Shkresën e datës 18.04.2024 drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm nga ankuesi; E-mailin e datës 22.04.2025 dërguar nga ankuesi për H.B me korrespondencën e bashkëngjitur; E-mailin e datës 22.04.2025 dërguar nga H.B për ankuesin; E-mailin e datës 18.04.2025 dërguar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm; Vendimin e Këshillit A.nr.876/2023 të datës 21.08.2023; Zarf postar i datës 16.05.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 23.05.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 26.05.2025; Akt Emërimit e ankuesit të datës 22.10.2024; Shkresë e datës 30.12.2021 lëshuar nga Presidenca e Republikës së Kosovës; Vendimin e datës 20.01.2022 të Ministres së MPJD-së; kërkesën e datës 11.07.2025 dërguar nga këshilli për H.B; Përgjigjen e datës 11.07.2025 dërgua nga H.B për Këshillin; Vendimin Nr.ref.275/2014 të datës 30.04.2014 të Ministrit të MPJD-së, Vendimin me shifër VK/2025 të datës 27.06.2025.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e parashtruara të lëndës nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit e datës 26.05.2025 është **pjesërisht e bazuar**, sepse: Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se ankuesi sipas Aktit të Emërimit Nr.5569 të datës 22.10.2024 është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në pozitën “*Drejtor i Departamentit për Organizata Ndërkombëtare*”, ndërsa Ministrja e MPJD-së, përmes Vendimit nr.Ref.92/2025 të datës 21.03.2025 e ka caktuar të shërbejë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Dhaka, në Republikën Popullore të Bangladeshit me mandat katër (4) vjeçar.

Ankuesi, përmes shkresës së dërguar te Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së përmes e-mailit zyrtar me datë 18.04.2025 ka shprehur pakënaqësitë e tij lidhur me caktimin e tij që të shërbejë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Dhaka, sikurse është përcaktuar në Vendimin e datës 21.03.2025 të Ministres së MPJD-së për shkak të pretendimeve të tij që lidhen me rrethanat familjare, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore të MPJD-së me datë 22.04.2025 i ka kthyer përgjigje ankuesit me njoftimin se Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm nuk ka mandat të shqyrtojë apo trajtojnë çështjet që ndërlidhen me Vendimet e nxjerra nga Ministrja e MPJD-së, ndërsa ankuesi përmes shkresës së datës 22.04.2025,ndërlidhur me kërkesën e

datës 18.04.2025, arsyeton dërgimin e ankesës në zyrë të sekretarit për arsye se akti kontestues që i referohet ankuesi nuk kishte këshillë juridike.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshill kundër Vendimit të datës 21.03.2025 të Ministres së MPJD-së, pretendon se pa dijeninë e tij është degraduar përmes aktit të kontestuar pasi që është caktuar të shërbejë në mision diplomatik me gradën Ministër Këshilltar, përderisa sipas Dekretit të datës 2019 është konfirmuar emërimi im si dhe Grada Diplomatike Ambasador, ngase sipas ligjeve në fuqi dhe kushtetutës, kompetentë për emërimin e Ambasadorëve është Presidentit i Republikës. Tutje ankuesi pretendon se, organi i punësimit ankuesit i kishte shqiptuar vërejtje me datë 02.06.2023 për shkak se i njëjti në korrespondencat e tij zyrtare kishte përdor titullin e gradës Ambasador, ashtu që Këshilli përmes Vendimit A.nr.876/2023 të datës 24.08.2025 e kishte aprovuar ankesën e tij ndërsa e kishte anuluar vërejtjen e dhënë si të pabazë dhe të kundërligjshme. Ankuesi, po ashtu pretendon se veprimet e Ministrisë së MPJD-së përmes aktit të kontestuar bien ndesh me dispozitat e nenit 27 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si dhe nenit 25 të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm pasi që përmes aktit të kontestuar më është humbur grada diplomatike Ambasador. Po ashtu, caktimi im që të shërbej në misionin përkatës bie ndesh me depozitat e nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm pasi që jam caktuar të shërbejë pa vullnetin apo gatishmërinë time, si dhe në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 2 të së njëjtës rregullore, veprimet e ministres bien ndesh me nenin 31, pika 1.3 e Ligjit për Shërbimin e jashtëm dhe po ashtu pretendon se Vendimi i datës 21.03.2025 i Ministres së MPJD-së është në kundërshtim me nenin 47 të LPPA-së, me kërkesën që të aprovohet ankesa e tij, ndërsa të anulohet akti i kontestuar.

Thënë si më lartë, Kolegji i Këshillit e analizoi Vendimin nr.Ref.92/2025 të datës 21.03.2025 të Ministres së MPJD-së, dhe konstatoi se akti në fjalë nuk përmban këshillën juridike, prandaj në mbështetje të nenit 127 paragraf 1, nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj”*, andaj ndërlidhur me nenin 129 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të të njëjtit ligj, ankesa i plotëson kushtet e pranueshmërisë, në kuptim të shqyrtimit meritor, pasi që ankesa e ankuesit e pranuar me datë 20.05.2025 në Këshill, kundër Vendimit Nr.Ref.92/2025 të datës 21.03.2025 të Ministres së MPJD-së, është parashtruar brenda afatit kohor sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 127 paragraf 1, nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Fillimisht, Kolegji i Këshillit analizoi aktin e kontestuar, respektivisht Vendimin nr.Ref.92/2025 të datës 21.03.2025, dhe konstatoi se përmes pikës I të dispozitiv të tij përcaktohet si në vijim: *“Z. U.E, me gradën diplomatike, Ministër Këshilltar, caktohet të shërbejë në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Dhaka, në Republikën Popullore të Bangladeshit”*, ndërsa akti në fjalë sipas përcaktimeve në preambulën e tij është nxjerrë mbi bazën e nenit 17, 18 dhe 22 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm, nenin 10 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm.

Kolegji i Këshillit lidhur me përcaktimin e thënë si më lartë, analizoi dhe mori për bazë dispozitat e nenit 17, 18 dhe 22 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm ku përcaktohet se: *“17.1. Funksionet diplomatike në shërbimin e jashtëm ushtrohen nga anëtarët e personelit diplomatik në pajtim me dispozitat e këtij ligji. 17.2. Gjatë ushtrimit të funksioneve diplomatike, personeli diplomatik ndihmohet nga personeli administrativ dhe teknik, dhe personeli shërbyes; 18. Përfaqësuesi diplomatik ushtron funksione dhe kryen detyra në shërbimin diplomatik të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën, Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, këtë ligj dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi; 22. Përfaqësuesit diplomatikë qëndrojnë në shërbim në të njëjtin mision*

diplomatik për një periudhe katër (4) vjeçare, ose ndryshe siç kërkohet për të përmbushur nevojat e Ministrisë dhe në diskrecion të Ministrit të Punëve të Jashtme.” si dhe nenin 10 paragrafi 2 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm ku përcaktohet se: “Stafi i Lartë Diplomatik, (Ministri, Ministër-Këshilltar, Sekretari i Parë) zakonisht caktohen për mandat 4 vjeçar.”

Nga konstatimet e pasqyruara si më lartë, dhe më qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dhe mori për bazë dispozitat e nenit 28 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm ku përcaktohet se: “**1. Avancimi i nëpunësve të shërbimit të jashtëm bëhet duke u mbështetur në sistemin e gradimit. Elementet kryesore në dhënien e një grade për anëtarin e shërbimit të jashtëm janë koha e shërbimit, kualifikimi dhe vlerësimi i rezultateve të punës. 2. Përveç gradës ambasador, gradat jepen nga Komisioni i Gradave dhe i Disiplinës, mbi bazën e të dhënave që ndodhen në dosjen personale të çdo punonjësi dhe në bazë të vlerësimeve të bëra, sipas kriterëve dhe rregullave të përcaktuara në Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm. 3. Grada diplomatike ambasador miratohet nga Presidenti, me propozimin e Qeverisë.**”, dhe konstatoi se është fakt i pakontestueshëm se Gradat Diplomatike Ambasador miratohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, ashtu që miratimit të gradës duhet t’i paraprijnë veprimet procedurale, respektivisht propozimi i Qeverisë për dhënien e Gradës Diplomatike Ambasador për zyrtarin përkatës, sikurse Kolegji i Këshillit mori për bazë edhe nenin 7 të Ligji Nr. 03/L-044 Për Ministrinë e Punëve të Jashtme Dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: “**7.1 Postet vakante për ambasadorë dhe shefa të misioneve duhet të shpallen edhe në kuadër të Shërbimit Civil. Procedurat për intervistimin dhe ngushtimin e listës së aplikantëve përcaktohen me anë të akteve nënligjore të Ministrisë. 7.2 Ministri i Punëve të Jashtme, pas konsultimit me Presidentin dhe Kryeministrin, ia dërgon një listë të ngushtë prej së paku tre kandidatë për secilin post vakant, në besim, Komisionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare të Kuvendit të Kosovës. Komisioni mban seanca të mbyllura dëgjimore për këta kandidatë për të vërtetuar se a i plotësojnë kriteret e parapara me nenin 6 të këtij ligji. Pas kësaj ua raporton rezultatet e dëgjimeve të tij, në konfidencë, Presidentit, Kryeministrin dhe Ministrit të Punëve të Jashtme. Raporti i Komisionit nuk përbën rekomandime lidhur me kandidatët të cilët plotësojnë kriteret nga neni 6 i këtij ligji. 7.3 Presidenti, pas konsultimit me Kryeministrin dhe Ministrin e Punëve të Jashtme vendos pastaj nëse njëri nga kandidatët duhet të emërohet për në shtetin pranues ose organizatën ndërqeveritare ndërkombëtare. Pasi të jetë marrë pëlqimi nga shteti pranues, Presidenti akrediton kandidatin e suksesshëm. 7.4 Pa paragjykuar nenin 8 të këtij ligji, përzgjedhja për postet e ambasadorëve ose shefave të tjerë të misioneve nuk kufizohet për shërbyes civilë. Megjithatë, së paku pesëdhjetë përqind (50%) të emërimeve të reja të shefave të misioneve, nga data pesë vite pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të bëhet nga anëtarët në detyrë të Shërbimit Diplomatik të Kosovës. 7.5 Emërimi i personelit tjetër në ambasadë ose misione jashtë bëhet në përputhje me legjislacionin i cili rregullon Shërbimin Civil dhe aktet nënligjore të Ministrisë. Këto akte nënligjore mund të parashohin kohëzgjatjen normale ose maksimale të emërimeve në ambasada ose misionë ose nderimeve të qëndrimit në detyrë në kuadër të selisë së Ministrisë.**” dhe konstatoi se procesi i emërimit të Shefave të Misioneve apo Ambasadorëve është proces i ndarë nga procesi i miratimit të Gradave Diplomatike Ambasador nga Komisioni i Gradave, mirëpo kjo bëhet përmes dekretit nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës, gjegjësisht miratimin e Gradës Diplomatike Ambasador jo domosdoshmërisht përcakton edhe dërgimin e tij në mision përmes të njëjtit akt apo dekret presidencial, sikurse jo domosdoshmërisht personat apo zyrtarët përkatës që caktohen të shërbejnë në pozita të ambasadorëve duhet të kenë Gradën Diplomatike Ambasador nga rrjedh se ligji i veçantë për Shërbimin e Jashtëm nuk e ka rregulluar në mënyrë specifike çështjen e kontestuar, pra nuk e ka rregulluar çështjen nëse dekreti për emërim në shërbimin diplomatik në pozitën Ambasador, njëkohësisht është akt i konfirmimit edhe gradës diplomatike Ambasador, apo anasjelltas.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se të njëjti përmes Dekretit Nr:209/2019 të datës 11.10.2019 të Presidentit të Republikës së Kosovës i është miratuar apo konfirmuar grada diplomatike Ambasador

dhe i njëjti është caktuar të shërbej në pozitën e Shefit të Misionit/Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Norvegjisë, me seli në Oslo, Kolegji i Këshillit konstatoi se është fakti i pamohueshëm se ankuesi përmes dekretit në fjalë të datë 11.10.2019 është caktuar të shërbej pozitën e Shefit të Misionit/Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Norvegjisë, dekret ky i nxjerrë mbi bazën e propozimit të ministrisë përkatëse-Qeverisë sipas nenit 7 të Ligji Nr. 03/L-044 Për Ministrinë e Punëve të Jashtme Dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës që lidhet me propozimin për plotësimin e pozitës së lirë.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit që i referohet vendimit të Këshillit A.nr867/2023 të datës 21.08.2023, është akt i pamohueshëm që përmes vendimit të cekur të Këshillit, të njëjtit i është aprovuar ankesa e tij e datës 22.06.2023 ndërsa është anuluar masa disiplinore “Vërejte” Nr.Ref.192/2023 e datës 02.06.2023, mirëpo në Vendimin e Këshillit A.nr867/2023 të datës 21.08.2023 as në dispozitiv dhe në asnjë pjesë të arsytimit të tij, nuk i është konfirmuar se i njëjti e ka gradën diplomatike ambasador, respektivisht në vendimin në fjalë është konstatuar fakti se ankuesi sipas Dekretit Nr:209/2019 të datës 11.10.2019 të presidentit të Republikës është emëruar të shërbejë në pozitën e Shefit të Misionit/Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Mbretërinë e Norvegjisë, me seli në Oslo, sikurse është konfirmuar fakti se përmes Dekretit Nr.203/2021 të datës 29.12.2021 Presidentja e Republikës së Kosovës ankuesin e ka tërhequr nga misioni, ndërsa ankesa e tij e datës 22.06.2023 është aprovuar vetëm mbi bazën e dispozitave nga neni 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të LPPA-s, që ndërlidhet me parimin e ligjshmërisë, proporcionalitetit, barazisë, mosdiskriminimit, objektivitetit, paanësisë, pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme, ngase lidhur me objektin e shqyrtimit të lëndës përkatëse, “vërejtjes” shqiptuesi i masës, respektivisht eprori i drejtpërdrejtë i ankuesit, asnjëherë nuk ia kishte tërhequr vërejtjen që i njëjti mos ta përdorë termin apo referencën Ambasador në korrespondencat zyrtare, madje kolegji kishte konstatuar se stafi brenda MPJD-së e kishte shndërruar në praktikë që kolegëve t’iu referohej me termet diplomatike lidhur me pozitat që kanë mbajtur apo kanë ushtruar në misione diplomatike jashtë shtetit, nga rrjedh si përmbledhje e këtij konstatimi se përmes Vendimit të Këshillit A.nr.876/2023 të datës 21.08.2023 ankuesit nuk i është konfirmuar grada përkatëse diplomatike sikurse i njëjti pretendon në këtë ankesë.

Kolegji i Këshillit përmes përfaqësuesit të autorizuar në këtë çështje administrative me datë 11.07.2025 i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore të MPJD-së me kërkesën për ofrimin e provave materiale, respektivisht akteve apo vendimeve përmes të cilave konfirmohet fakti i dhënies së gradave diplomatike për ankuesin, ndërsa kjo e fundit me datë 11.07.2025 përmes përgjigjes së dhënë ka përcjellë Vendimin Nr.ref.275/2014 të datës 30.04.2014 të Ministrit të MPJD-së, përmes së cilit konfirmohet fakti se ankuesit i është konfirmuar grada diplomatike Ministër Këshilltar, gjegjësisht organi i punësimit dhe as ankuesi nuk kanë ofruara ndonjë akt tjetër përmes të cilit konfirmohet fakti se ankuesi ka gradë tjetër diplomatike të përcaktuar në mënyrë specifike, ndërsa lidhur me çështjet e Dekretit të datës 11.10.2019, Kolegji i Këshillit ndau konstatimin si më lartë se me dekretin në fjalë ankuesi është emëruar të shërbejë në mision diplomatik, mirëpo përmes Dekretit në fjalë nuk mund të arrihet në konstatimin nëse të njëjtit njëkohësisht i është miratuar edhe grada diplomatike Ambasador ngase ligji material i veçantë për Shërbimin e Jashtëm nuk e ka rregulluar në mënyrë specifike çështjen e kontestuar, pra nuk e ka rregulluar çështjen nëse Dekreti për emërim në shërbimin diplomatik në pozitën Ambasador, njëkohësisht është akt presidencial përmes të cilit konfirmohet edhe grada diplomatike Ambasador, andaj edhe në mungesë të një qartësimi ligjor në këtë aspekt të potencuar si më lartë dhe në mungesë të provave të ofruara nga palët në këtë proces, kolegji i këshillit nuk ka mundë të nxjerrë një konstatim të saktë e që rezulton edhe me aprovim të pjesërishtëm të ankesës.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se caktimi im që të shërbej në misionin përkatës sipas Vendimit të datës 21.03.2025 të Ministres së MPJD-së, bie ndesh me depozitat e nenit 7 paragrafi 4 të

Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm pasi që jam caktuar të shërbejë pa vullnetin apo gatishmërinë time, si dhe në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 2 të së njëjtës rregullore, Kolegji i Këshillit iu referua dispozitave të nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *“1.Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunësves/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.2. anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm.... 2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin. 3. Në rast të rregullimit me ligj të veçantë, për shërbyesin civil me status të veçantë - dispozita mbizotëruese janë dispozitat e ligjit të veçantë...”* dhe konstatoi se nëpunësit e shërbimit të jashtëm kanë statusin e nëpunësve civil me status të veçantë, respektivisht marrëdhënia e punës dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës i nënshtrohet rregullimit ligjor sipas Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe ligjeve të veçanta lidhur me fushat e specifikuara sipas paragrafit 2 të nenit 6 të këtij ligji.

Në kontekst të përcaktimit si më lartë, Kolegji thekson faktin së Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nuk ka në fuqi ndonjë akt ligjor apo nënligjor që rregullon specifikisht apo në mënyrë të detajuar çështjet lidhur me caktimin, sistemimin apo emërimin e nëpunësve civilë në shërbim e jashtëm diplomatik apo konsullor, apo transferimin dhe ndërprerjen e shërbimit diplomatik-konsullor si dhe disiplinën, edhe pse në praktiken tani më të konsoliduar të vendimmarrjes në Këshill janë dhënë udhëzime që MPJD për shkak të specifikave të fushës së veprimit duhet të ketë procedura të qarta lidhur më çështjet si me sipër, nga rrjedh se institucionet publike në kuadër të ushtrimit të autorizimeve dhe përgjegjësisë nga fusha e veprimit ligjor, duhet të përcaktojnë qartë procedura të veprimit, përshirë edhe përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të zyrtarëve publik me theks të veçantë të nëpunësve civil me status të veçantë sikurse janë zyrtarët e shërbimit të jashtëm, procedura këto që garantojnë siguri juridike, profesionalizëm, konkurrencë dhe transparencë, prandaj mbi këtë bazë të këtij konstatimi, si dhe duke qenë se MPJD, siç u tha me sipër nuk ka akte ligjore që kanë rregulluar në mënyrë specifike çështjet të cilat janë objekt i shqyrtimit në këtë procedurë administrative, që ndërlidhet me procedurën e emërimit në shërbimin diplomatik apo konsullor, atëherë nisur edhe nga rasti i ankuesit, Kolegji Këshillit thekson faktin se në raste të tilla të ngjashme duhej të vinin në zbatim përshtatshmërisht procedurat e thirrjes për gradim duke dhënë mundësinë për shprehje të interesit për çdo zyrtarë që pretendon se i plotëson kriteret për emërim në pozitën përkatëse apo shprehjen e gatishmërisë nga ana e zyrtarëve për emërim në pozitën përkatëse në shërbim e jashtëm diplomatik respektivisht në misionin diplomatik apo konsullor, nga rrjedh se organi i punësimit zyrtarin përkatës të cilin e ka synim ta emërojë në pozitën përkatëse në shërbimin e jashtëm, fillimisht para se të nxirret akti për emërim në pozitën përkatës në shërbimin diplomatik jashtë vendi, do të duhej të njoftonte për synimet e organit të punësimit sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara nga neni 27 paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“27.1. Zyrtarja/i publik ka të drejtë të informohet për procedurat dhe vendimet lidhur me marrëdhënien e saj/tij të punës.”* ndërlidhur me nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“1. Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave. 2. Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme”,* dhe më pastaj organi i punësimit duhet të kërkojë nga zyrtari përkatës konfirmimin e gatishmërisë së tij për të shërbyer në pozitën përkatëse.

Mirëpo, Kolegji i Këshillit thekson faktin se zyrtari përkatës të cilit i kërkohet shprehja e gatishmërisë përpara se të emërohet në ndonjë pozitë përkatëse në shërbimin e jashtëm diplomatik apo konsullor, jo

domosdoshmërisht e ruan të drejtën për refuzim, pra jo apriori caktimi apo emërimi i tij varet në mënyrë të drejtpërdrejtë në dhënien e konfirmimit apo pëlqimit të tij, mirëpo mungesën e gatishmërisë zyrtari duhet ta arsyetojë me fakte dhe prova bindëse, e të cilat organi i punësimit duhet t'i vlerësojë, shqyrtoj dhe t'i trajtojë në frymën e parimeve të përgjithshëm të menaxhimit të marrëdhënies së punës të përcaktuara me nenin 8 paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“8.1. Menaxhimi i marrëdhënies së punës së nëpunëses/it civil, nëpunëses/it të shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it të artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknike dhe mbështetëse, bazohet në parimin e ligjshmërisë, integritetit, meritës, transparencës, profesionalizmit, paanësisë partiake dhe mosdiskriminimit”*, ngase edhe sipas paragrafit 2 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, pavarësisht faktit që lejon që me ligj të veçantë mund t'i rregullojë ndryshe elementet e marrëdhënies së punës, mirëpo të njëjtat duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj, sikurse në rrethanat e rastit konkret me dispozitat e nenit 8 të këtij ligji, kurse në rrethanat e rastit konkret Kolegji i Këshillit konstatoi se asnjëri nga veprimet e specifikuar nuk është ndërmarrë nga organi i punësimit.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit se akti i kontestuar nuk përmban elementet e përcaktuara si në nenin 47 të LPPA-së, analizoi aktin e kontestuar dhe konstatoi se të njëjtit i mungon këshilla juridike, përderisa kjo çështje është e përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 i LPPA-së, *“47.1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.”*

Prandaj nga se u tha si më lartë në konstatimet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e ankuesit e datës 20.05.2025 është pjesërisht e bazuar, ashtu që aprovohet pretendimi ankimor i ankuesit se Vendimit nr.Ref.92/2025 të datës 21.03.2025 i Ministres së MPJD-së është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e nenit 27 paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik si dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e përgjithshme Administrative nga neni 47, janë pretendime të bazuara, ngase zyrtari publik ka të drejtë të informohet për procedurat dhe vendimet lidhur me marrëdhënien e tij të punës, ngase veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave, sikurse në secilën rrethanë kur vendoset mbi të drejtat dhe detyrimet e zyrtarit, akti i cili e përcakton një detyrim duhet ta përmbajë edhe të drejtën e dhënies së këshillës juridike apo sugjerimin dhe udhëzimin në mjete të rregullta juridike, andaj mbi këtë bazë Vendimi nr.Ref.92/2025 të datës 21.03.2025 i Ministres së MPJD-së është akt u paligjshëm sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 52 paragrafi 1, në paragrafi 1.3 dhe 1.4 i LPPA-së ku përcaktohet se: *“1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;”* dhe i njëjti është shfuqizuar sikurse në arsyetimin e këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nenin 132 paragrafin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.913/2025, datë 01/08/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses, Avokat Xhafer Tahiri;
- Ministrisë së Punëve të jashtme dhe Diasporës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore dhe Komisionit të Ankesave), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.